



**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



**CENSS**  
Center for Security Studies

**KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG**

# ARSENALI NË RRITJE I VEPRIMEVE TË RUSISË: LIDHJA KOSOVË - UKRAINË





**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



**CENSS**  
Center for Security Studies



**KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG**

## **ARSENALI NË RITJE I VEPRIMEVE TË RUSISË: LIDHJA KOSOVË – UKRAINË**

### **PUBLIKUAR NGA:**

© Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

© Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)

© Qendra për Studime të Sigurisë ("CENSS")

### **AUTORË:**

Adelina Hasani,

Vadym Chernysh,

Viktorii Voronina

### **DIZAJN DHE PARAQITJE:**

Brand Vision Shpk

Contact: +383 45 559 923

Email: brandvision.rks@gmail.com

---

© Qëndrimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë medoemos qëndrimet e Konrad-Adenauer-Stiftung. Publikimi ka karakter informues dhe nuk lejohet të përdoret nga partitë politike apo nga kandidatët dhe mbështetësit e tyre për qëllime të fushatës elektorale

# Përmbajtja

RRETH AUTORËVE (SIPAS RADHËS ALFABETIKE)	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA	6
NDIKIMI I RUSISË NË KOSOVË	7
OPERACIONET INFORMATIVE TË RUSISË DHE NARRATIVA E "SHTETIT TË DËSHTUAR": RETORIKA NË KOSOVË DHE UKRAINË	9
DIPLOMACIA KULTURORE SI MJET I "FUQISË SË BUTË" TË RUSISË	23
PËRFUNDIME	28

# Rreth autorëve

(sipas radhës alfabetike)

## Adelina Hasani



Është studiuese dhe publiciste. Ajo ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Ankarasë. Masterin në të drejtat e njeriut dhe demokracinë në Evropën Juglindore e ka fituar në Universitetin e Sarajevës dhe Universitetin e Bolonjës (ERMA). Doktoraturën në marrëdhënie ndërkombëtare e ka përfunduar në Universitetin e Ankarasë me disertacionin me titull “Transformimi i politikës së sigurisë së Federatës Ruse: shtetet e ish-Jugosllavisë”. Adelina është autore e disa botieve dhe ka mbajtur prezantime akademike për çështjet gjinore, nacionalizmin në vendet e ish-Jugosllavisë dhe politikën e jashtme ruse. Kohëve të fundit ajo ka shërbyer edhe si këshilltare e jashtme në Ministrinë e Punëve të Jashtme gjatë përpjekjeve të Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës.

## Vadym Chernysh



Vadym Chernysh është ekspert në studimet e inteligjencës, sigurinë kombëtare dhe zgjidhjen e konflikteve, me përvojë të gjerë si në rolet akademike ashtu edhe në ato qeveritare. Në vitin 2012, Vadym Chernysh bashkëthemeloi Qendrën për Studime të Sigurisë “CENSS” ku aktualisht shërben si Kryetar i Këshillit Drejtues. Përvoja e tij qeveritare përfshin detyrën si Ministër për Territoret e Përkohshme të Okupuara të Ukrainës nga viti 2016 deri në vitin 2019. Ai ishte gjithashtu negociator në procesin e paqes në Minsk, duke adresuar konfliktin në Ukrainën Lindore. Vadym Chernysh ka një Ph.D. në drejtësi, me disertacionin e tij të fokusuar në kontrollin mbi agjencitë e inteligjencës së Ukrainës. Ai është autor i artikujve shkencorë që shqyrtojnë rolin e inteligjencës si instrument i pavarur i fuqisë shtetërore.

## Viktoriiia Voronina



Viktoriiia Voronina është Drejtore Ekzekutive e “CENSS” dhe ish-zëvendësministre për Territoret e Përkohshme të Okupuara të Ukrainës, me përvojë të gjerë në administratën publike dhe politikën e sigurisë. Që nga viti 2019, ajo ka udhëhequr iniciativat e CENSS në kohezion social, qëndrueshmëri, kundërvënien e kërcënimeve hibride, kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW) dhe DDR. Ajo ka punuar si eksperte për organizata ndërkombëtare—përfshirë OSBE-në dhe UNDP-në—dhe ka shërbyer si këshilluese e Ministrit për Çështje të Veteranëve (2023–2024). Përveç kësaj, ajo ligjëron në Departamentin e Administratës Publike në Institutin Politeknik të Kievit.

# Hyrje

---

Si aktor politik në Evropë, qëllim i kamotshëm i Rusisë ka qenë të krijojë ndikim përtej kufijve të saj të menjëhershëm, në mënyrë që të projektojë pozitë me pushtet dhe të sfidojë komunitetin euroatlantik. Një nga partnerët më të afërt në këtë përpjekje është Serbia, ku interesat e disa elitave politike përputhen me ato të Kremlinit.

Në vend se të mbështetet kryesisht në operacione tradicionale ushtarake, forca e Rusisë qëndron në përdorimin e gjerë të instrumenteve jo-ushtarake, shpesh të përshkruara si luftë hibride. Këto përfshijnë operacione kibernetike, fushata dezinformimi, ndikim politik, presion ekonomik dhe mbështetje për aktorë të ndërmjetëm. Moskë zotëron një gamë të gjerë të ashtuquajturave “masa nën pragun e luftës”, të cilat i përdor në mënyrë aktive dhe është e gatshme t’i ndajë me aleatët e saj, në ndjekje të objektivave strategjike dhe ambicieve politike të partnerëve.

Serbia, nga ana e saj, e percepton Rusinë si një aleat të fuqishëm dhe me përvojë, dhe mbetet i vetmi shtet në Ballkanin Perëndimor që nuk ka vendosur sanksione ndaj Rusisë pas pushtimit të përvokuar dhe në shkallë të plotë të Ukrainës. Për më tepër, Rusia ka forcuar praninë e saj në rajon duke u përfshirë më tej në mosmarrëveshjet e pazgjidhura, veçanërisht në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë. Përmes këtij angazhimi, Rusia zgjeron ndikimin e saj politik në Ballkanin Perëndimor, duke i paraqitur këto konflikte si pjesë e një lufte më të gjerë kundër “Perëndimit” dhe vlerave të tij liberal-demokratike. Kjo strategji shërben gjithashtu si një mjet diversioni për Kremlinin: duke nxitur tensione në Ballkanin Perëndimor, Rusia zhvendos vëmendjen ndërkombëtare nga lufta e saj e vazhdueshme e agresionit kundër Ukrainës.

Ndonëse pushtimi në shkallë të plotë i Ukrainës filloi në vitin 2022, lufta ndërmjet Rusisë dhe

Ukrainës në fakt nisi në vitin 2014 me aneksimin e paligjshëm të Krimesë nga Rusia. Në atë kohë, lufta hibride e Rusisë tashmë ishte në zhvillim e sipër, veçanërisht përmes manipulimit mediatic.

Lufta hibride ka qenë një taktikë qendrore e Rusisë, e orientuar drejt identifikimit dhe shfrytëzimit të cënueshmërive shoqërore për të zgjeruar ndikimin e saj të dëmshëm dhe për të destabilizuar vendet e synuara. Rusia ka shfrytëzuar popullatat rusisht-folëse, diplomacinë publike dhe fenë për të formësuar perceptimin publik dhe për të mëtuar kontroll. Këto mjete kanë amplifikuar ndasitë gjuhësore dhe kulturore brenda shoqërisë ukrainase, duke forcuar fragmentimin e brendshëm dhe duke minuar kohezionin shtetëror.<sup>1</sup>

Të njëjtat narrativa propagandistike të përdorura kundër Ukrainës po aplikohen tani edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në Kosovë dhe Bosnje e Hercegovinë, për të avancuar interesat strategjike të Rusisë në rajon. Këto narrativa synojnë të promovojnë një ideologji alternative kundrejt aleancave perëndimore, shpesh duke i paraqitur Kosovën dhe Bosnjën e Hercegovinën si dështime të politikave perëndimore. Të projektuara nga Kremli dhe të amplifikuara nga Serbia, këto narrativa nxjerrin paralele të qarta me mesazhet e përdorura kundër Ukrainës, duke i vendosur këto shtete në një diskurs të ngjashëm të “shteteve të dështuara.”

Ky raport shqyrton strategjitë, qasjet dhe metodat që Rusia ka përdorur në Ukrainë si pjesë e luftës hibride dhe mënyrën se si këto mjete po përshtaten ose po amplifikohen në Ballkanin Perëndimor. Duke analizuar këto dinamika, synojmë të nxjerrim në pah mekanizmat përmes të cilëve Rusia ushtron ndikim në rajon dhe implikimet e mundshme për sigurinë rajonale dhe stabilitetin euroatlantik.

---

1 Intervistë me Viktoriia Voronina, drejtor ekzekutiv i CENSS, 2024, Inside Security, <https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=tBBPbx-Enjs>

# Metodologjia

---

Metodologjia e këtij raporti bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të kërcënimeve jo-konvencionale të Rosisë, me vëmendje të veçantë ndaj mënyrës se si këto kërcënime ndërtohen dhe përhapen përmes narrativave të artikuluara nga institucionet shtetërore. Këto narrativa nuk përhapen vetëm përmes platformave dhe mediave të ndryshme, por janë të mishëruara edhe në praktikat e përditshme shoqërore, shpesh duke u manifestuar si forma ekstremizmi të ushtruara nga individë të ndryshëm. Duke shqyrtuar dokumente zyrtare shtetërore, fjalime, deklarata të politikave dhe forma të tjera komunikimi të prodhuara nga zyrtarët shtetërorë, raporti analizon mënyrat se si koncepti i “Botës Ruse” dhe diplomacia kulturore përdoren në mënyrë strategjike për të zgjeruar ndikimin e Rosisë në Kosovë dhe në rajonin më të gjerë të Ballkanit. Kjo qasje mundëson identifikimin e paraleleve ndërmjet strategjive të Rosisë në Ballkan dhe ndërhyrjeve të saj në Ukrainë, duke ofruar një perspektivë krahasuese mbi ndërtimin, përhapjen dhe amplifikimin e narrativave.

Ky hulumtim fokusohet posaçërisht në narrativat e përdorura nga Rusia si në Ukrainë ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në Kosovë, duke shqyrtuar mënyrën se si këto narrativa amplifikohen, riformësohen dhe përforcohen nga institucione të caktuara shtetërore dhe

media që synojnë Kosovën.

Hulumtimi dokumentar përfshiu një shqyrtim të detajuar të dokumenteve zyrtare, narrativave shtetërore, literaturës akademike, raporteve të politikave dhe mbulimit mediatic, duke i mundësuar ekipit të hulumtimit të krijojë një hartë të kanaleve dhe mekanizmave të ndryshëm përmes të cilëve operon ndikimi rus. Përveç hulumtimit dokumentar, studimi përfshiu tetë intervista gjysmë të strukturuar me një gamë aktorësh, përfshirë përfaqësues shtetërorë, gazetarë, ekspertë, studiues dhe aktorë të shoqërisë civile në Kosovë. Këto intervista u projektuan për të kapur perceptimet lokale mbi metodat jo-konvencionale të Rosisë dhe për të kuptuar se si këto narrativa rezonojnë, interpretohen ose kundërshtohen brenda konteksteve të ndryshme shoqërore dhe institucionale.

Studimi u zhvillua nga prilli deri në korrik 2025, duke ofruar një kornizë kohore të fokusuar për të shqyrtuar ndryshimet në narrativa, modelet e përhapjes dhe ndikimin lokal të strategjive jo-konvencionale të Rosisë. Duke përdorur shumë mjete hulumtimi dhe qasje metodologjike, ky raport ofron një kuptim të detajuar dhe shumëdimensional mbi mënyrën se si Rusia ndërton, përhap dhe mban ndikimin e saj në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor.

# Ndikimi i Ruisë në Kosovë

---

Rusia historikisht ka ruajtur lidhje të ngushta me popullatat sllave, me të cilat ndan fenë dhe kujtesën historike kolektive. Këto afinitete i kanë mundësuar Moskës të kultivojë lidhje të forta në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht me shtetet me shumicë sllave si Serbia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Përkundrazi, ndikimi rus në Shqipëri është minimal, ndërsa në Kosovë ushtrohet kryesisht përmes popullatës serbe.<sup>2</sup>

Ambicia e Ruisë për të zgjeruar ndikimin e saj në rajon është intensifikuar teksa mëton të paraqitet si një fuqi e rëndësishme si në politikën rajonale ashtu edhe në atë globale. Ky rivalitet gjeopolitik reflektohet në mbështetjen e Moskës për forcat nacionaliste, të cilat i shfrytëzojnë për të nxitur tensione ndëretnike, sidomos në Bosnje e Hercegovinë dhe në marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Këto dinamika minojnë stabilitetin rajonal dhe ngadalësojnë përparimin e Ballkanit Perëndimor drejt integritetit në BE dhe NATO. Megjithatë, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të ndjekin anëtarësimin në NATO, ndërsa të gjitha synojnë aderimin në BE. Lufta në Ukrainë ka sjellë kompleksitete shtesë në këto procese integruese.

Strategjia e Ruisë në Ballkanin Perëndimor është përqendruar në thellimin e varësisë rajonale nga energjia ruse, në shfrytëzimin e pozitës së saj në institucionet ndërkombëtare për të penguar zgjidhjet e udhëhequra nga Perëndimi, si dhe në promovimin e narrativave anti-perëndimore. Rusia synon të zgjerojë ndikimin e saj mbi shtetet fqinje, vendet evropiane dhe Ballkanin Perëndimor përmes një game të gjerë "kërcënimesh hibride", që përfshijnë dezinformimin, sulmet kibernetike, shtrëngimin ekonomik, presionin ushtarak dhe ndërhyrjen politike. Ekspertët vlerësojnë se Rusia ndan midis 1 dhe 4 miliardë dollarë çdo vit për përpjekjet e saj në luftën informative.<sup>3</sup> Për

shembull, në vitin 2021, autoritetet e Kosovës arrestuan gazetaren ruse Daria Aslanova, e cila po përhapte propagandë ruse dhe dyshohej për spiunazh.<sup>4</sup>

Propaganda kundër Kosovës zë një vend të posaçëm në narrativën e politikës së jashtme të Ruisë. Moska e përdor vazhdimisht rastin e Kosovës si një mjet për të sfiduar Perëndimin, duke e paraqitur ndërhyrjen e NATO-s si të paligjshme.<sup>5</sup> Strategjia e Ruisë fokusohet më pak në ndikimin e drejtpërdrejtë mbi vetë Kosovën dhe më shumë në përdorimin e çështjes së mbrojtjes së interesave të Serbisë në arenat ndërkombëtare për të minuar sovranitetin e Kosovës dhe për të bllokuar integritetin e saj në sistemin global. Rusia refuzon të njohë pavarësinë e Kosovës dhe kundërshton në mënyrë aktive anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare, duke u mbështetur në fuqinë e vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për të bllokuar subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Për Kremlinin, një zgjidhje e konfliktit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës do të dobësonte levën e tij në Serbi dhe do të minonte ndikimin më të gjerë në Ballkan, ku Serbia mbetet aleati i tij kryesor. Në nivel gjeopolitik, interesi i Ruisë për Kosovën lidhet më pak me ndikimin e drejtpërdrejtë brenda territorit dhe më shumë me mundësinë për ta instrumentalizuar Kosovën në forumet globale. Në këtë mënyrë, Moska e pozicionon veten si kundërpeshë ndaj Perëndimit dhe forcon imazhin e saj si mbrojtëse e botës sllave dhe ortodokse, duke rritur kështu qëndrueshmërinë e saj brenda shoqërisë serbe.

Përfshirja e Ruisë në Kosovë gjithnjë e më shumë është bërë pjesë e fushatës së saj më

---

[com/a/7551995.html](https://www.zeramerikes.com/a/7551995.html)

4 Radio Evropa e Lirë, 2012, <https://www.evropaelire.org/a/kush-eshte-daria-aslanova/31977359.html>

5 Ramadan Ilazim Ardit Orana dhe Jeta Loshaj, Kosova në diskursin e politikës së jashtme ruse- Nxitja e paqëndrueshmërisë në Kosovë dhe kundërvënia ndaj integritetit euro-atlantik. QKSS dhe KAS, 2024, <https://qkss.org/en/publikimet/kosova-ne-diskursin-e-politikes-se-jashtme-ruse-nxitja-e-paqendrueshmerise-ne-kosove-dhe-kundershtimi-i-integritetit-euro-atlantik/>

---

2 Alfred Marleku and Dafina Aliu, Russia's Influence on the European Integration Process of the Western Balkan Countries: A Comprehensive Analysis, UNISCI Journal, n.62, Maj 2023.

3 Zëri i Amerikës, 2024, <https://www.zeramerikes.com/a/7551995.html>

të gjerë kundër NATO-s dhe SHBA-së,<sup>6</sup> duke u përafuar ngushtë me qëndrimin politik të Serbisë ndaj aleancës perëndimore.<sup>7</sup> Rusia vazhdon të veprojë si aktor me ndikim të dëmshëm në Kosovë, duke përdorur fushata dezinformimi për të nxitur tensione ndëretnike dhe për të penguar dialogun me Serbinë. Këto narrativa synojnë kryesisht popullatën serbe në Kosovë, ku Rusia paraqitet si mbrojtëse e tyre, ndërsa synon të minojë integritimin e tyre me institucionet perëndimore.<sup>8</sup>

Një nga strategjitë kryesore të Rusisë në Ballkanin Perëndimor është shfrytëzimi i forcave nacionaliste për të nxitur tensione ndëretnike, siç shihet në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë. Në Kosovë, Kremlinin është mbështetur fuqishëm në fushata dezinformimi dhe keqinformimi, veçanërisht në veriun e Kosovës, i cili është i banuar kryesisht nga grupet e minoritetit serb. Platforma online, grupe në rrjetet sociale dhe media tipi "tabloid" përdoren për të ndjellë frikë dhe mosbesim, me synimin për të mobilizuar popullatën serbe kundër qeverisë së Kosovës duke e paraqitur atë si armiqësore dhe kërcënuese.<sup>9</sup>

Propaganda ruse synon gjithashtu të delegjitimojë institucionet ndërkombëtare, veçanërisht NATO-n dhe KFOR-in. Media të tilla si *Sputnik*, *Russia Today* dhe platformat sociale, përfshirë Telegram, TikTok dhe X, i paraqesin forcat e NATO-s si të njëanshme kundër serbëve, duke minuar besimin në aleancë. Këto përpjekje dezinformuese amplifikohen më tej përmes mediave lokale, si *Informer*, *Media Alo* dhe *TV Pink*, të cilat janë gjerësisht të qasshme në veriun e Kosovës.<sup>10</sup> Këto platforma shpesh

e paraqesin qeverinë e Kosovës si antagonistin ndaj popullatës serbe. Për shembull, *Informer* publikoi një artikull ku akuzonte Kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, duke e etiketuar në mënyrë pezhorative si "regjimi i Kurtit", për tentativa për të dëbuar serbët nga Kosova. Narrativa të tilla e portretizojnë qeverinë si armiqësore dhe jo-bashkëpunuese, duke e tëhuajtur më tej komunitetin serb.<sup>11</sup> Megjithatë, propaganda ruse është e përhapur gjerësisht brenda komunitetit serb në Kosovë, kryesisht përmes platformave në Telegram, të cilat përdoren veçanërisht nga ky komunitet, dhe komunikimi kryesor në këto grupe zhvillohet në gjuhën serbe. Dy grupet kryesore që synohen nga këto fushata dezinformimi në Telegram janë "Bunt je stanje duha" (shq. Rebelimi është gjendje shpirtërore) me mbi 87,200 abonentë, dhe "Koridor" me 19,500 abonentë. Postimet nacionaliste shpesh e paraqesin Rusinë si mbrojtëse të serbëve në Kosovë. Ato përhapin narrativa mbi rikthimin e mundshëm të ushtrisë serbe në Kosovë dhe përndjekjen e pretenduar të komunitetit serb.

Rusia shpesh nis operacionet e saj të ndikimit përmes mjeteve të "fuqisë së butë" (ang. *soft power*), duke transmetuar filma, duke adresuar çështje të përditshme dhe duke u paraqitur si aleate kulturore; mirëpo, taktikat e saj ndryshojnë varësisht nga konteksti. Narrativat ruse e kanë portretizuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si një organizatë terroriste ose islamiste, duke e paraqitur Kosovën si një "shtet të dështuar," duke reflektuar narrativa të ngjashme të përdorura kundër Ukrainës.<sup>12</sup>

Ndërsa Rusia kryesisht synon të zgjerojë ndikimin e saj në rajon përmes dezinformimit dhe nxitjes së tensioneve etnike, ajo gjithashtu pozicionohet si aktor i rëndësishëm duke shfrytëzuar kontekste të brishta si Kosova dhe Bosnja e Hercegovina. Narrativat që përdor në këto vende pasqyrojnë ngushtë ato të zbatuara në Ukrainë që nga viti 2014. Një taktikë qendrore është narrativa e "shtetit të dështuar," e përdorur kundër Ukrainës dhe e aplikuar në mënyrë të ngjashme ndaj Kosovës.

6 BIRN, "Vorbulla e rrenave". <https://kallxo.com/wp-content/uploads/2023/11/VORBULLA-E-RRENAVE-FINALE.pdf>

7 <https://carnegieendowment.org/research/2019/11/a-spoiler-in-the-balkans-russia-and-the-final-resolution-of-the-kosovo-conflict?lang=en>

8 Festim Rizanaj dhe Alban Zeneli, Krahaskimi Ukrainë-Kosovë në narrativat dezinformuese të Rusisë, Action for Democratic Society/ Hybrid.info, 2024. <https://hibrid.info/krahaskimi-ukraine-kosove-ne-narrativat-dezinformuese-te-rusise/>

9 Adelina Hasani, "Luftimi i Ekstremizmit në Kosovë: Sfidat, prirjet dhe kundërmasat, Sbunker, 2024.

10 Center for Research, Transparency and Accountability, <https://cra.rs/en/report-mapping-disinformation-in-the-serbian-media/> dhe intervistë me një gazetar hulumtues. Tetor 2024, Prishtinë, Kosovë.

11 Adelina Hasani, Luftimi i Ekstremizmit në Kosovë: Sfidat, prirjet dhe kundërmasat. Sbunker, 2024.

12 Po aty.

# Operacionet informative të Ruisë dhe narrativa e “shtetit të dështuar”: Retorika në Kosovë dhe Ukrainë

Ka rëndësi thelbësore të njihet se narrativat përbëjnë një komponent themelor të operacioneve dhe fushatave informative, si dhe mjete vendimtare të propagandës shtetërore dhe komunikimit strategjik. Në kontekstin e këtij raporti, funksioni i tyre kryesor është të formësojnë qëndrimet, emocionet dhe perceptimet, me qëllim të justifikimit, mbështetjes ose legjitimitimit të sjelljeve, veprimeve apo mosveprimeve të caktuara.

Narrativa e “shtetit të dështuar” është qëndisur për të ndikuar opinionin publik brenda dhe jashtë vendit, si dhe pikëpamjet e elitave në pushtet, duke përforcuar idenë se dikush tjetër duhet të kujdeset për territorin dhe popullatën e shtetit të synuar. Nëse ky objektivi arrihet, bëhet më e lehtë të justifikohet vendosja e një forme tjetër qeverisjeje në shtetin e synuar ose madje edhe ndërhyrja ushtarake kundër tij.

Që nga fillimi i viteve 2000, udhëheqja më e

lartë e Federatës Ruse ka promovuar në mënyrë sistematike idenë se Ukraina është një “shtet i dështuar,” i pazoti për sovranitet, i varur nga fuqitë e huaja dhe i destinuar të shembet. Kjo narrativë është artikuluar nga presidenti Vladimir Putin, zyrtarë të lartë të sigurisë dhe përfaqësues të politikës së jashtme ruse, duke shërbyer si një justifikim ideologjik për agresionin dhe si një mjet i luftës informative kundër Kievit dhe partnerëve të tij perëndimorë.

Një nga shembujt më të hershëm eksplicit erdhi nga Putin në samitin e NATO-s në Bukuresht në vitin 2008, ku ai i tha presidentit amerikan George W. Bush se “Ukraina nuk është as shtet.” Me këtë rast, në fjalimin e tij zyrtar në të njëjtin samit, Putin nuk e humbi mundësinë për të përmendur Kosovën si një “shkelje flagrante të së drejtës ndërkombëtare.”<sup>13</sup>

13 Kremlin.ru. <http://kremlin.ru/events/president/news/44078>

## Matrica në vijim paraqet një përzgjedhje të deklaratave nga zyrtarët e lartë rusë për Ukrainën si “shtet i dështuar”.

<b>Data</b>	Prill 2008 (Samit i NATO-s, takim i mbyllur)
<b>Folësi, pozita</b>	Vladimir Putin, president i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Kur biseda u kthye te Ukraina, Putin humbi durimin. Duke iu drejtuar Bush-it, ai tha: “E kupton, George, se Ukraina nuk është as shtet! Çfarë është Ukraina? Një pjesë e territorit të saj është Evropë Lindore, dhe një pjesë tjetër, një pjesë e konsiderueshme, na është dhënë neve!” Këtu ai e bëri shumë të qartë se, nëse Ukraina do të pranohej në NATO, vendi thjesht do të pushonte së ekzistuari. Me fjalë të tjera, ai praktikisht kërcënoi se Rusia mund të fillonte tentativën të rikthente Krimenë dhe Ukrainën Lindore.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.kommersant.ru/doc/877224">https://www.kommersant.ru/doc/877224</a>

<b>Data</b>	Prill 2008 (Samiti i NATO-s në Bukuresht, deklaratë zyrtare)
<b>Folësi, pozita</b>	Vladimir Putin, president i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Në përgjithësi, Ukraina është një shtet shumë i komplikuar. Ukraina, në formën që ekziston aktualisht, u krijua në kohën e Bashkimit Sovjetik; ajo mori territore nga Polonia pas Luftës së Dytë Botërore, nga Çekosllovakia dhe nga Rumania, dhe ende sot nuk janë zgjidhur të gjitha problemet në rajonin kufitar me Rumaninë në Detin e Zi. Pastaj, ajo mori territore të mëdha nga Rusia në lindje dhe jug të vendit. Është një formacion shtetëror i komplikuar. Nëse i shtojmë problemet e NATO-s, problemet e tjera, kjo mund ta vendosë shtetin buzë greminës së ekzistencës së tij.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.unian.info/world/111033-text-of-putin-s-speech-at-nato-summit-bucharest-april-2-2008.html">https://www.unian.info/world/111033-text-of-putin-s-speech-at-nato-summit-bucharest-april-2-2008.html</a>

<b>Data</b>	Maj 2009
<b>Folësi, pozita</b>	Vladimir Putin, president i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	<i>"A i keni lexuar ditarët e Denikin-it? Duhet patjetër t'i lexoni! Ai diskuton Rusinë e Madhe, Rusinë e Vogël dhe Ukrainën. Ai thotë se askush nuk duhet të lejohet të ndërhyjë në marrëdhëniet mes nesh, se kjo ka qenë gjithmonë vetëm çështje e Rosisë!"</i>
<b>Burimi</b>	<a href="https://kp.ua/politics/180937-putyn-nazval-ukraynu-maloi-rossyei-y-pryzval-vernut-edynstvo">https://kp.ua/politics/180937-putyn-nazval-ukraynu-maloi-rossyei-y-pryzval-vernut-edynstvo</a>

<b>Data</b>	Mars 2014 (fjalim për "justifikimin" e pushtimit të Krimesë)
<b>Folësi, pozita</b>	Vladimir Putin, president i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Krimea është trashëgimia jonë e përbashkët historike dhe një faktor shumë i rëndësishëm për stabilitetin rajonal. Ky territor strategjik duhet të jetë pjesë e një sovraniteti të fortë dhe të qëndrueshëm, i cili sot mund të jetë vetëm rus.
<b>Burimi</b>	<a href="http://en.kremlin.ru/events/president/news/page/693">http://en.kremlin.ru/events/president/news/page/693</a>

<b>Data</b>	Prill 2016
<b>Folësi, pozita</b>	Dmitry Medvedev, kryeministër i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	<i>"Ç'kuptim ka të bëjmë paralele me Ukrainën në këtë drejtim... Paj, jo, thjesht po them se atje nuk ka as industri, as shtet... Në vitin 2013? Po, kishte industri, por shtet nuk kishte as atëherë."</i>
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.themoscowtimes.com/2016/04/05/russian-prime-minister-ukraine-has-no-industry-or-state-a52385">https://www.themoscowtimes.com/2016/04/05/russian-prime-minister-ukraine-has-no-industry-or-state-a52385</a>

<b>Data</b>	Korrik 2021 (Artikull nga Vladimir Putin <i>"Mbi unitetin historik të rusëve dhe ukrainasve"</i> )
<b>Folësi, pozita</b>	Vladimir Putin, president i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Autorët perëndimorë të projektit anti-rus e kanë ndërtuar sistemin politik të Ukrainës në atë mënyrë që presidentët, deputetët dhe ministrat të ndryshojnë, por qëndrimi i ndarjes dhe armiqësisë ndaj Rusisë të mbetet.  Jam i bindur se sovraniteti i vërtetë i Ukrainës është i mundur vetëm në partneritet me Rusinë. Lidhjet tona shpirtërore, njerëzore dhe civilizuese janë formuar ndër shekuj dhe kanë origjinën në të njëjtat burime; sprovat, arritjet dhe fitoret e përbashkëta i kanë forcuar ato. Afërsia jonë është transmetuar brez pas brezi. Ajo gjendet në zemrat dhe kujtesën e njerëzve që jetojnë në Rusinë dhe Ukrainën moderne, në lidhjet e gjakut që bashkojnë miliona familjet tona. Së bashku, gjithmonë kemi qenë dhe do të jemi shumë më të fortë dhe më të suksesshëm. Sepse ne jemi një popull i vetëm.
<b>Burimi</b>	<a href="http://en.kremlin.ru/events/president/news/66181">http://en.kremlin.ru/events/president/news/66181</a>

<b>Data</b>	Tetor 2021
<b>Folësi, pozita</b>	Dmitry Medvedev, zëvendëskryesues i Këshillit të Sigurisë së Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Ukraina është në kërkim të identitetit të saj dhe të një rruge unike, duke ndërtuar historinë e vet të veçantë (edhe pse historia na mëson se kjo zgjat me shekuj). Por udhëheqësit ukrainas, veçanërisht zyrtarët e lartë, janë <i>njerëz që nuk kanë një vetë-identifikim të qëndrueshëm</i> . Njerëz të palumtur. Kush janë ata, cilit vend i përkasin, nga i kanë rrënjët e tyre, cili është identiteti i tyre historik, komponenti etnik, dhe cilëve zotë u luten? Si ndihen ata? A janë 'të sinqertë'.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.kommersant.ru/doc/5028300?from=glavnoe_1#id2123318">https://www.kommersant.ru/doc/5028300?from=glavnoe_1#id2123318</a>

<b>Data</b>	21 shkurt 2022
<b>Folësi, pozita</b>	Vladimir Putin, president i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	<p>Si rezultat i politikës bolshevike, lindi Ukraina Sovjetike. Mund të quhet me të drejtë Ukrainë, e emërtuar sipas Leninit. Ai është autori dhe arkitekti i saj; ka dokumente. Dhe tani, pasardhësit mirënjohës kanë rrënuar monumentet e Leninit në Ukrainë; këtë e quajnë de-komunizëm.</p> <p>Ukraina moderne u krijua plotësisht nga Rusia, më saktë nga Rusia bolshevike, komuniste. Ky proces filloi menjëherë pas revolucionit të vitit 1917, dhe Lenini me bashkëpunëtorët e tij e bënë këtë në një mënyrë shumë të ashpër ndaj vetë Ruisë – duke e ndarë, duke i shkëputur asaj pjesë të territoreve të saj historike.</p> <p>Në fakt, Ukraina kurrë nuk ka pasur një traditë të qëndrueshme të shtetësisë së saj të vërtetë. Që nga viti 1991, ajo ka ndjekur rrugën e kopjimit mekanik të modeleve të huaja, të shkëputura nga historia dhe realitetet ukrainase. Institucionet politike shtetërore janë riformësuar vazhdimisht për t'u përshtatur me klane të formuara shpejt, me interesa vetjake që nuk kanë të bëjnë me interesat e popullit të Ukrainës.</p> <p>Shtetësia e qëndrueshme nuk është vendosur kurrë në Ukrainë, dhe procedurat politike e elektorale shërbejnë vetëm si mbulesë, si tymnajë për ri-shpërndarjen e pushtetit dhe pasurisë ndërmjet klaneve të ndryshme oligarkike.</p> <p>Maidan-i nuk e afrooi Ukrainën me demokracinë dhe progresin. Duke organizuar një grusht shteti, nacionalistët dhe forcat politike që i mbështetën ata e çuan situatën në një bllokim të plotë dhe e zhytën Ukrainën në humnerën e luftës civile. Tetë vite pas atyre ngjarjeve, vendi është i ndarë. Ukraina po përjeton një krizë akute socio-ekonomike.</p> <p>Në realitet, kolapsi i ekonomisë ukrainase është shoqëruar me grabitje të hapur të qytetarëve të vendit, dhe vetë Ukraina është vendosur thjesht nën kontroll të jashtëm. Kjo po kryhet jo vetëm me urdhra nga kryeqytetet perëndimore, por edhe drejtpërdrejt në terren përmes një rrjeti të tërë këshilltarësh të huaj, OJQ-ve dhe institucioneve të tjera të vendosura në Ukrainë. Ata kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të gjitha vendimet e rëndësishme për personelin, në të gjitha degët dhe nivelet e qeverisjes, nga qendrore deri te komunale, si dhe në ndërmarrjet dhe korporatat kryesore shtetërore.</p>
<b>Burimi</b>	<a href="http://kremlin.ru/events/president/news/67828">http://kremlin.ru/events/president/news/67828</a>

<b>Data</b>	Dhjetor 2022
<b>Folësi, pozita</b>	Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme të Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Historia e këtyre vendeve, ashtu si e gjithë historia e Ukrainës, është e pandashme nga ajo e Ruisë, dhe çdo tentativë e regjimit të Kievit për ta rishkruar është e destinuar të dështojë.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.justsecurity.org/81789/russias-eliminationist-rhetoric-against-ukraine-a-collection/">https://www.justsecurity.org/81789/russias-eliminationist-rhetoric-against-ukraine-a-collection/</a>

<b>Data</b>	Nëntor 2023
<b>Folësi, pozita</b>	Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme të Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Sot është me vend të bëhet pyetja: çfarë saktësisht i dha 'Euromaidan' Ukrainës? Përgjigjja është e qartë. Nga një republikë e vetë-mjaftueshme, e industrializuar dhe e populluar e ish-BRSS-së, <b>Ukraina është shndërruar në një territor të varfër, në shuarje</b> . Vendi ka humbur pavarësinë e tij shtetërore dhe mbështetet nga kolonialistët perëndimorë, të cilët përcaktojnë politikën e tij të brendshme dhe të jashtme.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.justsecurity.org/81789/russias-eliminationist-rhetoric-against-ukraine-a-collection/">https://www.justsecurity.org/81789/russias-eliminationist-rhetoric-against-ukraine-a-collection/</a>

<b>Data</b>	Dhjetor 2023
<b>Folësi, pozita</b>	Sergey Lavrov, ministër Jashtëm i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	<p>Gjatë takimit Rusi-NATO, Presidenti rus i pyeti të gjithë për vendimin e tyre. Ai vazhdoi të shpjegonte natyrën e brishtë të shtetësisë ukrainase, mënyrën se si ajo u krijua, çfarë ndodhi kur rajonet perëndimore u bënë pjesë e Bashkimit Sovjetik, dhe çfarë duhej bërë që ato të jetonin në harmoni me popullin rus dhe traditat e tij. Ai shpjegoi gjithçka. Mesazhi ishte se veprimet e NATO-s do ta prishnin këtë ekuilibër të brishtë. Njerëzit në Ukrainën perëndimore dhe lindore jetonin brenda një shteti të vetëm, por kishin pak gjëra të përbashkëta, madje edhe në aspektin e datave përkujtimore.</p> <p>Nga fundi i prillit 2014, sekretari amerikan i shtetit, asokohe John Kerry, propozoi një takim në Gjenevë. Ai solli me vete Catherine Ashton, kryediplomaten e BE-së, dhe ministrin e jashtëm të Ukrainës, në detyrë, Andrey Deshchitsa... Patëm bisedë të mirë dhe u pajtuam për një dokument prej rreth një faqe e gjysmë a dy...Dokumenti trajtonte nevojën për tranzicionin e Ukrainës drejt një strukture federale dhe nisjen e përpjekjeve për hartimin e një traktati federal me pjesëmarrjen e të gjithë krerëve të rajoneve ukrainase pa përjashtim. Ky propozim u duk si diçka e natyrshme për John Kerry dhe Catherine Ashton, por dokumenti nuk u miratua kurrë. Megjithatë, në atë kohë ekzistonte një mirëkuptim në Uashington dhe Londër se kjo mund të ishte një rrugëdalje për të parandaluar një zinxhir reagimesh dhe përkeqësim të mëtejshëm të situatës.</p>
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1923676/">https://www.mid.ru/en/foreign_policy/news/1923676/</a>

<b>Data</b>	Shkurt 2024
<b>Folësi, pozita</b>	Vladimir Putin, president i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	<p>Pas fitimit të pavarësisë, Ukraina filloi të kërkonte, siç thonë disa analistë perëndimorë, identitetin e saj. Dhe nuk gjeti asgjë më të mirë sesa ta ndërtonte këtë identitet mbi disa 'heronj të rremë' që kishin bashkëpunuar me Hitlerin.</p> <p>Unë kam thënë tashmë se në fillim të shekullit XIX, kur u shfaqën teoricienët e pavarësisë dhe sovranitetit të Ukrainës, ata supozuan se një Ukrainë e pavarur duhej të kishte marrëdhënie shumë të mira me Rusinë. Por, për shkak të zhvillimit historik, këto territore ishin pjesë e Federatës Polako-Lituanese – Polonisë, ku ukrainasit u persekutuan dhe u trajtuan mjaft brutalisht dhe iu nënshtruan sjelljeve mizore. Kishte gjithashtu tentativa për të shkatërruar identitetin e tyre.</p>
<b>Burimi</b>	<a href="http://kremlin.ru/events/president/news/73411">http://kremlin.ru/events/president/news/73411</a>

<b>Data</b>	Maj 2024
<b>Folësi, pozita</b>	Vyacheslav Volodin, kryetar i Duma-s së Shtetit Rus
<b>Citati</b>	<p>Ukraina ka pushuar së ekzistuari si shtet i së drejtës që nga viti 2014. Dhjetë vite më parë, Washingtoni dhe Brukseli, me duart e nazistëve në Kiev, kryen një grusht shteti të përgjakshëm. Banditët dhe nazistët zunë pozitat drejtuese. Dhe ata që nuk pajtoheshin me këtë u hodhën pas grilave, u vranë, u dogjën të gjallë.</p>
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.justsecurity.org/81789/russias-eliminationist-rhetoric-against-ukraine-a-collection/">https://www.justsecurity.org/81789/russias-eliminationist-rhetoric-against-ukraine-a-collection/</a>

<b>Data</b>	Maj 2024
<b>Folësi, pozita</b>	Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme të Federatës Ruse
<b>Citati</b>	<p>E kemi parë se çfarë është bërë Ukraina ndër vite — një shtet i dështuar, një vend i izoluar i shtyrë në humnerën e civilizimit nga ideologjia neo-naziste, amnezia historike dhe promovimi i çdo lloj vesesh.</p>
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.justsecurity.org/81789/russias-eliminationist-rhetoric-against-ukraine-a-collection/">https://www.justsecurity.org/81789/russias-eliminationist-rhetoric-against-ukraine-a-collection/</a>

<b>Data</b>	Nëntor 2024 (Takimi i krerëve të shërbimeve të sigurisë dhe inteligjencës të vendeve anëtare të Komunitetit të Shteteve të Pavarura, shkurt CIS)
<b>Folësi, pozita</b>	Sergey Naryshkin, the drejtor i Shërbimit të Inteligjencës së Jashtme të Federatës Ruse
<b>Citati</b>	<a href="#">Ukraina</a> sot është një shtet i dështuar, dhe Perëndimi, nga ana e vet, po punon me qëllim për të destabilizuar situatën në të gjitha rajonet e botës. <a href="#">Shtetet e Bashkuara</a> dhe vendet perëndimore janë në kontakt me nacionalistët në vendet e CIS-it për të zbatuar 'skenarin ukrainas', duke shtuar se Perëndimi dëshiron të përdorë mercenarë për të destabilizuar situatën në Bjellorusi para zgjedhjeve presidenciale.
<b>Burimi</b>	<a href="https://en.iz.ru/en/1796987/2024-11-26/naryshkin-calls-ukraine-failed-state">https://en.iz.ru/en/1796987/2024-11-26/naryshkin-calls-ukraine-failed-state</a>
<b>Data</b>	Janar 2025
<b>Folësi, pozita</b>	<a href="#">Nikolai Patrushev</a> , këshillatar i presidentit rus, ish-sekretar i Këshillit të Sigurisë
<b>Citati</b>	Është veçanërisht shqetësuese që detyrimi i dhunshëm për të përqaftuar ideologjinë neo-naziste dhe rusofobinë e ashpër po shkatërron qytetet dikur të begata në Ukrainë, përfshirë Kharkivin, Odesën, Mykolaivin dhe Dnipropetrovskin.  Ukraina mund të pushojë së ekzistuari krejtësisht vitin e ardhshëm.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.kp.ru/daily/27651/5036217/">https://www.kp.ru/daily/27651/5036217/</a>

Pretendimet e politikanëve po mbështeten nga akademikë dhe ekspertë në Rusi, si dhe nga studiues mbështetës të Rusisë nga vende të tjera, të cilët po publikojnë raporte me argumente të rreme rreth faktit se Ukraina nuk është një vend i vërtetë dhe se kontrollohet nga SHBA dhe BE. Njëri prej tyre që e përhap këtë narrativë është Sergey Karaganov, një politolog rus, kryetar i Këshillit për Politikën e Jashtme dhe të Mbrojtjes, dhe dekan në Shkollën e Lartë të Ekonomisë në Moskë, i cili konsiderohet gjithashtu i afërt me Putin-in dhe ministrin e Jashtëm Sergey Lavrov. Në vitin 2014, ai foli për paaftësinë e autoriteteve ukrainase për të qeverisur vendin: "23 vite pavarësi... Dhe çdo vit, qeverisja e vendit përkeqësohej, dhe çdo brez pasues i udhëheqësve bëhej më i keq se i mëparshmi, më i korruptuar dhe më pak i aftë. Ukraina nuk ka zhvilluar një

elitë shtet-formuese, dhe vendi duket se ka nevojë për qeverisje të jashtme. Do të ishte më mirë nëse Evropa dhe Rusia do ta ofronin bashkërisht këtë qeverisje të jashtme". Më vonë, në vitin 2018, ai vazhdoi ta mbronte këtë ide: "Ukraina është një shtet joefektiv. Në vitet që nga pavarësia, nuk ka dalë asnjë ide kombëtare në këtë vend. Shërbimi ndaj interesave të Perëndimit dhe Shteteve të Bashkuara nuk mund të quhet ide kombëtare. Dhe ata që e udhëheqin shoqërinë ftojnë me vetëdije sundimin e jashtëm, perëndimor. Krahasuar me situatën e saj nën BRSS, gjithçka në Ukrainë po përkeqësohet: ekonomia, teknologjia, industria dhe standardet sociale. Sot, Ukraina njihet si një nga vendet më të varfra në Evropë. Mendoj se ndoshta jo në të ardhmen e afërt, por në planin afatgjatë, ne do të biem dakord me evropianët për

një formë të qeverisjes së përbashkët.”<sup>14</sup> E njëjta retorikë erdhi prej tij gjatë Forumit Ekonomik Ndërkombëtar në Shën Petersburg në vitin 2024, kur ai tha se regjimi i Kievit ishte moralisht, politikisht dhe madje edhe ligjërisht i paligjshëm, madje edhe nga perspektiva e shtetit të dështuar që ekzistonte atje.<sup>15</sup>

Autoritetet ruse, qendrat kulturore, bizneset dhe politikanët kanë punuar njëkohësisht për të minuar sovranitetin, integritetin territorial dhe stabilitetin e shtetit ukrainas brenda vendit. Ka prova të shumta që sugjerojnë se Federata Ruse ka përdorur një arsenal të gjerë mjetesh jo-ushtarake kundër Ukrainës. Këto mjete përfshijnë

propagandën; ndërhyrjet ekonomike dhe politike, për shembull ato që mund të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve, duke synuar të diskreditojnë disa politikanë ndërsa promovojnë të tjerë; vjedhjen kibernetike të të dhënave dhe përdorimin e mëtejshëm të tyre për të shkaktuar dëme ose për të ushtruar ndikim; përdorimin e grupeve kriminale për ryshfet, shantazh, shtypje ose detyrim; nxitjen e polarizimit të shoqërisë, organizimin dhe shtytjen e protestave për destabilizim, etj.

Tentativat e Rusisë për ta paraqitur Ukrainën si një “shtet të dështuar,” një narrativë që ajo e ka aplikuar gjithashtu ndaj Kosovës dhe që është përforcuar nga Serbia në retorikën e saj kundër Kosovës, shkojnë përtej mesazheve të drejtuara si ndaj komunitetit ndërkombëtar ashtu edhe ndaj audiencave të brendshme.

14 Shih: <https://ukraina.ru/20180511/1020326885.html>

15 Shih: <http://en.kremlin.ru/events/president/transcripts/74234>

**Matrica më poshtë ilustron se si Rusia e ka përdorur rastin e Kosovës si një “shtet të dështuar” në narrativat e saj, kryesisht për të legjitimuar politikat e saj agresive në Ukrainë dhe për të justifikuar praninë dhe aleancën e saj me popullin serb.**

<b>Data</b>	17 shkurt 2009
<b>Folësi, pozita</b>	Boris Tadic, president i Serbisë
<b>Citati</b>	Tadic këmbënguli se Kosova nuk ishte një shtet i pavarur pavarësisht shpalljes së saj të shkëputjes, duke e përshkruar si një shtet të dështuar, të karakterizuar posaçërisht nga shqetësimet për të drejtat e njeriut.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.france24.com/en/20090217-kosovo-not-state-serbias-president-says-">https://www.france24.com/en/20090217-kosovo-not-state-serbias-president-says-</a>

<b>Data</b>	5 shtator 2019
<b>Folësi, pozita</b>	Aleksandr Lukashevich, i dërguari rus në OSBE
<b>Citati</b>	Duke folur në OSBE, Lukashevich e përshkroi Kosovën si një entitet gjysmë-shtetëror që kishte dështuar, duke vënë në dukje numrin në rritje të shteteve që po tërhiqnin njohjen e pavarësisë së saj.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.voanews.com/a/false-russia-s-osce-rep-claims-kosovo-a-failed-quasi-state-entity-/6742232.html">https://www.voanews.com/a/false-russia-s-osce-rep-claims-kosovo-a-failed-quasi-state-entity-/6742232.html</a>

<b>Data</b>	Tetor 2019
<b>Folësi, pozita</b>	Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme të Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Vendet që kanë njohur Kosovën mund ta përsërisin sa herë të duan se Kosova është shtet, por kjo nuk do ta bëjë atë shtet. Kjo u deklarua nga përfaqësuesja zyrtare e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova, në një konferencë për shtyp në Moskë, më 17 tetor, duke iu përgjigjur një pyetjeje nga korrespondenti i <a href="#">EADaily</a> nëse ajo pajtohej me deklaratën e kreut të ardhshëm të diplomacisë evropiane, Josep Borrell, se Kosova nuk do të jetë shtet përderisa Kina, India dhe Rusia nuk e njohin atë.
<b>Burimi</b>	<a href="https://eadaily.com/ru/news/2019/10/17/zaharova-kosovo-ne-gosudarstvo-i-nikogda-im-ne-stanet">https://eadaily.com/ru/news/2019/10/17/zaharova-kosovo-ne-gosudarstvo-i-nikogda-im-ne-stanet</a>

<b>Data</b>	28 qershor 2021
<b>Folësi, pozita</b>	Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme të Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Zakharova deklaroi se projekti perëndimor i Kosovës kishte dështuar, duke e quajtur një vrimë të zezë në Evropë ku lulëzonin krimi dhe korrupsioni, dhe duke këmbëngulur se Kosova nuk ishte shtet.
<b>Burimi</b>	<a href="https://www.panorama.am/en/news/2021/06/28/Kosovo-Maria-Zakharova/2527132">https://www.panorama.am/en/news/2021/06/28/Kosovo-Maria-Zakharova/2527132</a>

<b>Data</b>	Tetor 2022
<b>Folësi, pozita</b>	
<b>Citati</b>	"Qeveria e republikës së vetëshpallur, ende, pothuajse 15 vite më vonë, i plotëson dobët këto kërkesa: në veçanti, ajo mezi qeveris Kosovën Veriore, ku jeton shumica e popullsisë serbe të rajonit. Duke dështuar të zbatojë procedurat bazë demokratike, si një referendum kombëtar, dhe duke shkelur të drejtën ndërkombëtare, Kosova në realitet ka mbetur një entitet territorial artificial – një shtet i dështuar."
<b>Burimi</b>	<a href="https://rapsinews.ru/publications/20220924/308309602.html">https://rapsinews.ru/publications/20220924/308309602.html</a>

<b>Data</b>	
<b>Folësi, pozita</b>	Sergey Lavrov, ministër i Jashtëm i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Lavrov e përdori Kosovën si shembull për të legjitimuar pozicionet ruse, duke argumentuar se njohja e Kosovës nga Perëndimi ishte dëshmi e vetëvendosjes selektive.
<b>Burimi</b>	<a href="https://sbunker.org/en/disinfo/lavrovi-e-permend-kosoven-ne-perpjekjen-per-ti-legjitimuar-qendrimet-kunder-perendimit/">https://sbunker.org/en/disinfo/lavrovi-e-permend-kosoven-ne-perpjekjen-per-ti-legjitimuar-qendrimet-kunder-perendimit/</a>

<b>Data</b>	6 dhjetor 2024
<b>Folësi, pozita</b>	Sergey Lavrov, ministër i Jashtëm i Federatës Ruse
<b>Citati</b>	“Koncepti i ‘sovrانيتit’ të vetëshpallur të Kosovës ka dështuar. Ai nuk gëzon mbështetje unanime as në Ballkan, as në Evropë, as në pjesë të tjera të botës. Rreth gjysma e shteteve anëtare të OKB-së nuk e njohin ‘shtetësinë’ famëkeqe të Kosovës, dhe numri i këtyre vendeve po rritet. Gjithnjë e më shumë kryeqytete po bëhen të vetëdijshme për të gjithë dëmin (përfshirë edhe për veten e tyre) të precedentit të krijuar në Kosovë të ndërhyrjes së dhunshme nga jashtë në punët e një shteti të pavarur nën pretekste të sajara. Situata në vetë rajonin e thekson qartë dështimin e pavarësisë së Kosovës.”
<b>Burimi</b>	<a href="https://rg.ru/2020/06/18/rg-publikuet-sovmestnuuiu-statiu-ministrov-inostrannyh-delf-i-serbii.html">https://rg.ru/2020/06/18/rg-publikuet-sovmestnuuiu-statiu-ministrov-inostrannyh-delf-i-serbii.html</a>

<b>Data</b>	30 janar 2025
<b>Folësi, pozita</b>	Alexander Grushko dhe Maria Zakharova, Ministria e Jashtme e Federatës Ruse
<b>Citati</b>	Zyrtarët rusë pretenduan se Perëndimi po ushtronte presion mbi Serbinë, duke e përshkruar Kosovën si të paligjshme dhe jofunksionale, si pjesë e fushatës së tyre më të gjerë të dezinformimit.
<b>Burimi</b>	<a href="https://sbunker.org/en/disinfo/zyrtaret-ruse-intensifikojne-fushatat-dezinformuese-ndaj-kosoves/">https://sbunker.org/en/disinfo/zyrtaret-ruse-intensifikojne-fushatat-dezinformuese-ndaj-kosoves/</a>

<b>Data</b>	21 shkurt 2025
<b>Folësi, pozita</b>	Marko Djuric (ministër i Jashtëm i Serbisë) & Sergey Lavrov
<b>Citati</b>	Në përvjetorin e pavarësisë së Kosovës, Djuric dhe Lavrov e hodhën sërish poshtë shtetësinë e Kosovës, duke e quajtur shpallje të njëanshme të paligjshme pavarësisht vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.
<b>Burimi</b>	<a href="https://sbunker.org/en/disinfo/zyrtaret-serbe-e-ruse-e-kontestojne-shtetesine-e-kosoves-pavaresisht-vendimit-te-gjnd-se/">https://sbunker.org/en/disinfo/zyrtaret-serbe-e-ruse-e-kontestojne-shtetesine-e-kosoves-pavaresisht-vendimit-te-gjnd-se/</a>

<b>Data</b>	Mars 2025
<b>Folësi, pozita</b>	Zyrtarë të Ministrisë së Jashtme të Federatës Ruse (të ndryshëm)
<b>Citati</b>	Përfaqësuesit rusë keqpërdorën Rezolutën 1244 të KS të OKB-së për të argumentuar se Kosova duhet të kthehet nën autoritetin e Serbisë, duke shpërfillur mandatin e rezolutës për vetëqeverisje të përkohshme.
<b>Burimi</b>	<a href="https://sbunker.org/en/disinfo/manipulimi-i-zyrtareve-ruse-me-rezoluten-1244/">https://sbunker.org/en/disinfo/manipulimi-i-zyrtareve-ruse-me-rezoluten-1244/</a>

<b>Data</b>	
<b>Folësi, pozita</b>	Ministria e Jashtme e Federatës Ruse
<b>Citati</b>	"Ju e dini pozicionin e Rusisë: në këtë rast, ne po flasim për një shkelje të rëndë të së drejtës ndërkombëtare, sovranitetit, integritetit territorial," deklaroi ajo. "E gjitha kjo është e përcaktuar në rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të cilat askush nuk i ka anuluar; ato janë ende në fuqi. Rezulton se 'në terren' – në sferën politike, juridike – ato janë nëpërkëmbur rëndë (kjo shprehje është kaç fisnike), ato janë shkelur. Vendet kanë shkelur rezolutën aktuale të Këshillit të Sigurimit të OKB-së duke e njohur Kosovën si një shtet sovran. Qëndrimi ynë ndaj kësaj nuk ka ndryshuar aspak. Përveç vlerësimeve politike, të cilat në rastin tonë bazohen në të drejtën ndërkombëtare, ka edhe realitete. Kosova si shtet nuk është realizuar as në aspektin juridik, as në realitetet e botës moderne. Mund të flitet për këtë temë sa të doni, por ka kaluar mjaft kohë, dhe e gjithë bota ka parë kotësinë e tentativave për të këmbëngulur në të vetën."
<b>Burimi</b>	<a href="https://rg.ru/2019/10/17/mid-rf-kosovo-eto-ne-gosudarstvo.html">https://rg.ru/2019/10/17/mid-rf-kosovo-eto-ne-gosudarstvo.html</a>

Rusia, ndër të tjera, e ka përdorur Kosovën si precedent për të ndërtuar narrativa të destinuara të justifikojnë ndërhyrjet e saj ushtarake në rajone të ndryshme të ish-BRSS. Pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë në vitin 1999 dhe njohjes së

pavarësisë së Kosovës nga vendet perëndimore në vitin 2008, Rusia ka pretenduar legjitimitet për veprimet e saj, përfshirë aneksimin e Krimesë në vitin 2014, njohjen e territoreve të kontestuara në Gjeorgji, si Abkhazia dhe Osetia e Jugut në

vitin 2008, dhe, më së fundi, rajonet e Donetskut dhe Luhanskut në Ukrainë në vitin 2022.<sup>16</sup> Qëllimi kryesor i Ruisë është të justifikojë agresionin e saj kundër Ukrainës dhe të legjitimojë pretendimet e saj mbi trashëgiminë historike të Ruisë së Kievit dhe Krimesë, duke shpresuar të vendosë ligjshmërinë e pushtimeve të saj në Osetinë e Jugut, Abkhazi dhe Transnistri.<sup>17</sup>

Monitorimi i fushatës zgjedhore nga BIRN Kosova tregon se Kosova është përmendur 32 herë midis shtatorit 2024 dhe marsit 2025 nga ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, me narrativën kryesore të fokusuar në kontestimin e shtetësisë dhe sovranitetit të saj si një shtet i dështuar, si dhe me akuzat për spastrim etnik të serbëve të Kosovës.

Rusia shpesh e paraqet Kosovën si një burim të vazhdueshëm tensioni dhe konflikti në Ballkanin Perëndimor, duke theksuar shqetësimet për sigurinë e serbëve në Kosovë. Për shembull, gazeta Informer publikoi një artikull ku akuzonte kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, të cilin e etiketonte në mënyrë pezhorative si "regjimi i Kurtit", për tentativa për të dëbuar serbët nga Kosova.<sup>18</sup> Kjo narrativë e paraqet qeverinë e Kosovës si armiqësore dhe jo-bashkëpunuese, duke tëhuajtur më tej komunitetin serb. Pretendime të tilla shpesh amplifikohen nga propaganda e mbështetur nga Kremli, duke forcuar narrativën se qeveria e Kosovës synon të marginalizojë ose të dëbojë serbët.<sup>19</sup> Një tjetër pretendim i rremë nga Informer ishte se "Kurti dëshiron të eliminojë Listën Serbe dhe të krijojë Shqipërinë e Madhe," duke nxitur më tej tensionet etnike.<sup>20</sup> Kjo narrativë synon gjithashtu të përforcojë perceptimin se Kosova është një shtet i paqëndrueshëm dhe se përpjekjet e Perëndimit për paqe kanë dështuar. Kosova po ashtu paraqitet në mënyrë të rreme si një

qendër rekrutimi për terrorizëm, me zyrtaren ruse Maria Zakharova që e quajti atë një "bastion të terrorizmit." Sipas kësaj narrative dezinformuese, Ukraina përballet me një kërcënim edhe më të rëndë nga terrorizmi, duke sugjeruar se aktivitetet terroriste atje janë më të përhapura dhe më të sofistikuar.

Rusia gjithashtu promovon idenë se myslimanët nga Shqipëria, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina paraqesin një kërcënim për përhapjen e ekstremizmit fetar në Ballkan. Media ruse dhe pro-ruse e portretizojnë Kosovën si një vend të fundamentalizmit islamik, separatizmit dhe ekstremizmit.<sup>21</sup> Përveç kësaj, krahas Ruisë dhe narrativës së amplifikuar në Serbi që e paraqet Kosovën si një vatrë të ekstremizmit fetar, Agjencia e Inteligjencës së Serbisë (BIA) ka luajtur gjithashtu një rol në lehtësimin e përhapjes së ekstremizmit brenda Kosovës. Një shembull i dukshëm është rasti i Hysni Selimit, një ekstremist fetar i arrestuar në vitin 2025. Sipas raporteve të disponueshme, Selimi ishte rekrutuar nga BIA për të mbledhur inteligjencë mbi rrjetet lokale ekstremiste, ndërkohë që përdorej njëkohësisht për të nxitur krijimin dhe rritjen e këtyre grupeve.<sup>22</sup> Ky rast ilustron një strategji të qëllimshme nga Rusia dhe Serbia për të manipuluar dhe forcuar rrjetet ekstremiste në Kosovë, duke destabilizuar rajonin dhe duke përforcuar narrativat e pasigurisë dhe të shtetit të dështuar.

Kur u drejtohet audiencave perëndimore, Rusia shpesh paraqet Kosovën dhe Bosnjë e Hercegovinën si shtete të dështuara dhe si vatra të fundamentalizmit islamik dhe ekstremizmit, duke synuar të gjenerojë skepticizëm ndaj këtyre vendeve dhe të forcojë narrativat e ekstremit të djathtë kundër Kosovës. Përkundrazi, kur angazhohet me audiencat afrikane dhe të Lindjes së Mesme, Rusia e paraqet veten si një aktor anti-kolonial që i bën ballë ndikimit perëndimor.<sup>23</sup> Në të njëjtën kohë, ajo mban një qëndrim nënshtrues

16 Festim Rizanaj dhe Alban Zeneli, Krahësimi Ukrainë-Kosovë në Narrativat dezinformuese të Ruisë, Action for Democratic Society/ Hybrid.info, 2024. <https://hibrid.info/wp-content/uploads/2024/11/Comparison-of-Ukraine-and-Kosovo-in-Russias-disinformation-narratives.pdf>

17 Po aty.

18 Informer, <https://informer.rs/politika/vesti/975085/aljbin-kurti-kosmet-srbi-maltretiranje>

19 Sbunker, Rusia dramatizon me gjendjen e serbëve në Kosovë, pretendon pa fakte se ata po dëbohen me miratimin e Perëndimit. <https://sbunker.org/en/disinfo/rusia-dramatizon-me-gjendjen-e-serbeve-ne-kosove-pretendon-pa-fakte-se-ata-po-debohen-me-miratimin-e-perendimit/>

20 Po aty.

21 Festim Rizanaj and Alban Zeneli, Comparison of Ukraine and Kosovo in Russia's disinformation narratives, Action for Democratic Society/ Hybrid.info, 2024. <https://hibrid.info/wp-content/uploads/2024/11/Comparison-of-Ukraine-and-Kosovo-in-Russias-disinformation-narratives.pdf>

22 Kallxo.com, <https://kallxo.com/lajm/arrestimi-i-te-dyshuarit-per-spiunazh-e-bashkepunitim-me-bia-n-serbe-bik-mos-bini-ne-kurthet-e-rrymave-devijante/>

23 Intervistë personale nr.2. Ekspert i sigurisë. Prishtinë. Prill 2025.

dhe kërcënues ndaj fqinjëve të saj, duke vënë Kosovën dhe Bosnjë e Hercegovinën në kornizën e shteteve të mbështetura nga Perëndimi, pa e theksuar aspektin fetar që nxjerr në pah në mesazhet e saj për audiencat perëndimore.

Përmes kësaj narrative “anti-koloniale”, Rusia ka shfrytëzuar gjithashtu bashkëpunimin e ngushtë me liderë myslimanë si Ramzan Kadyrov i Çeçenisë, një anëtar kyç i rrethit të brendshëm të Presidentit Vladimir Putin. Për shembull, në qershor 2024, Kadyrov njoftoi se 500 afrikanë ishin dërguar në Haxh me shpenzimet e Fondacionit Shoqëror Rajonal të emërtuar për nder të babait të tij, dhe se kishte filluar ndërtimi i pesë xhamive për myslimanët afrikanë.<sup>24</sup> Dmitry Dubrovsky, politolog dhe ligjërues i sociologjisë në Universitetin Charles, thekson: “Afrika është një rajon i rëndësishëm për Rusinë, dhe ajo po përpiqet të depërtojë atje në mënyra të ndryshme, siç bëri përmes Prigozhin dhe kompanive private ushtarake. Kjo është një tjetër arsye pse Kadyrov u inkurajua të ndërtonte xhami atje. Afrika është kritike ndaj Putin-it, i cili e paraqet veten si një ‘anti-kolonizues,’ dhe tani Kadyrov po portretizon miqësi dhe po ofron forma të ndryshme të mbështetjes humanitare.”<sup>25</sup> Dubrovsky gjithashtu thekson se disa vende, si Arabia Saudite, ushtrojnë mjete klasike të “fuqisë së butë” përmes ndërtimit të xhamive dhe strukturave të tjera kulturore. “Një xhami është një strukturë e rëndësishme, por është gjithashtu një shenjë e pranisë politike dhe kulturore,” vëren ai.<sup>26</sup> Ndërkohë që rajonet ruse zakonisht nuk zhvillojnë politika të pavarura të jashtme, Çeçenia ka qenë prej kohësh një përjashtim. Politologu rus Ivan Preobrazhensky shpjegon: “Kjo është sepse Ramzan Kadyrov funksionon si një lloj fondacioni për ‘Botën Jo-Ruse’ në emër të qeverisë ruse, ose si një ‘Ministri e Jashtme e Sheriatit’ e Federatës Ruse.”<sup>27</sup>

Vlen të ceket se asnjë operacion i fshehtë, qoftë ushtarak apo jo-ushtarak, nuk fillon pa përgatitje. Për këto qëllime, vendi i synuar studiohet me kujdes, me fokus te problemet e brendshme. Identifikimi i mosmarrëveshjeve (të

ashtuquajturave “shkaqe rrënjësore”) në fushat politike, ekonomike, kulturore, sociale dhe të tjera të shoqërisë së vendit të synuar është një element thelbësor në përgatitjen për planifikimin strategjik të një grupi gjithëpërfshirës masash të nevojshme dhe të intensitetit të tyre. Nëse këto masa kanë sukses, shoqëria e vendit të synuar bëhet e brishtë, duke e bërë atë objektiv të lehtë dhe duke rrezikuar vetë ekzistencën e saj.

Për qëllime të ushtrimit të ndikimit mbi vendin e synuar, të pasurit e një kufiri të përbashkët, historie të përbashkët, kulture, feje, gjuhe, origjine kombëtare e kështu me radhë, të ngjashme është një avantazh i qartë.<sup>28</sup>

Një kusht i rëndësishëm është përdorimi i mjeteve ushtarake dhe jo-ushtarake në një mënyrë që krijon “mohim të arsyeshëm” (ang. plausible deniability), apo mundësinë për të mohuar përfshirjen si palë në konflikt. Kjo shpjegon shfaqjen e të ashtuquajturave “njerëzit të gjelbër” (ang. little green men) në Krime, pjesëtarë të forcave ushtarake me uniforma të gjelbra pa shenja dalluese, përdorimin e aktorëve të ndërmjetëm (ang. proxy) për të kryer operacione ushtarake, si dhe stërvitjet ushtarake që janë të padallueshme nga përgatitjet reale për pushtim (mjete ushtarake). Mjetet jo-ushtarake gjithashtu përdoren në një mënyrë që patjetër mundëson “mohimin e arsyeshëm” për sa i përket qëllimit të vërtetë të këtyre veprimeve.

Duke amplifikuar ndasitë kulturore, duke nxitur frikë dhe duke shfrytëzuar pabarazitë ekonomike të Ukrainës, si dhe në Ballkanin Perëndimor, duke nxitur ndasitë etnike dhe duke orkestruar fushata dezinformimi, veçanërisht në Kosovë, Rusia ka synuar të mbajë shoqëritë të fragmentuara dhe të brishta. Kjo strategji e kamotshme e destabilizimit të brendshëm ka shtruar terrenin për agresionin e hapur të mëvonshëm të Moskës.<sup>29</sup>

Narrativa e “shtetit të dështuar”, e dukshme si në Kosovë ashtu edhe në Ukrainë, është e stisur qëllimisht nga Rusia për të formësuar opinionin publik brenda dhe jashtë vendit, si dhe për të lëkundur elitën në pushtet. Mesazhi i saj kryesor sugjeron se territori dhe popullsia e një shteti

24 [https://t.me/RKadyrov\\_95/4851](https://t.me/RKadyrov_95/4851)

25 Фонд Кадырова профинансирует строительство пяти мечетей в Африке, <https://www.kavkazr.com/a/fond-kadyrova-profinansiruet-stroiteljstvo-pyati-mechetey-v-afrike/32996231.html?form=MG0AV3&form=MG0AV3>

26 Po aty.


27 Po aty.

28 “Smart power” against Hybrid Threats, CENSS, <https://censs.org/smart-power-against-hybrid-threats/>

29 Vadym Chernysh, Viktoriia Voronina, Overview of the Armed Conflict in eastern Ukraine – a Context and Conflict Analysis: analytical report, Kyiv, 2020. – f. 164.

të synuar nuk mund të vetëqeverisen dhe për këtë arsye kërkojnë mbikëqyrje të jashtme. Pasi ky perceptim të marrë hov, bëhet më e lehtë të justifikohet imponimi i formave alternative të qeverisjes apo edhe nisja e një ndërhyrjeje ushtarake.

### LULËZIMI I BRISHTËSIS



# Diplomacia kulturore si mjet i “fuqisë së butë” të Rusisë

Diplomacia kulturore mund të përkufizohet si shkëmbimi i qëllimshëm dhe strategjik i ideve, vlerave, traditave dhe elementeve të tjera kulturore me synimin për të nxitur mirëkuptim të ndërsjellë, për të forcuar marrëdhëniet, për të avancuar bashkëpunimin socio-kulturor dhe për të promovuar interesa kombëtare ose ndërkombëtare. Ajo mund të zhvillohet nga institucione shtetërore ose nga aktorë privatë, secili duke kontribuar në objektivin më të gjerë të ndërtimit të besimit dhe dialogut përtej ndasive kulturore.<sup>30</sup>

Rusia e përdor diplomacinë kulturore si një mjet strategjik për të ushtruar ndikim politik mbi punët e brendshme të shteteve të synuara, duke ndikuar kështu në strukturat qeverisëse dhe institucionet publike të tyre. Diplomacia kulturore konsiderohet pjesë e strategjisë së “fuqisë së butë”, e cila kombinohet me forma të tjera të fuqisë shtetërore. “Fuqia e butë” nënkupton aftësinë për të ndikuar në veprimet, sjelljet ose paradigmat e vlerave të tjerëve në mënyrë indirekte, pa përdorur detyrim apo stimuj materialë, por përmes motivimeve të tjera.

Rusia ka zhvilluar një koncept të njohur gjerësisht si “Bota Ruse”. Një dimension i këtij koncepti synon të krijojë bazën për ndërhyrje, përfshirje ose pushtim në vende të tjera duke u mbështetur në kushte historike dhe kulturore. “Bota Ruse” përfshin elemente të ndryshme, si kulturën, nën-kulturën dhe historinë, dhe paraqitet si një hapësirë kulturore e civilizuese që tejkalon kufijtë territorialë të Rusisë së sotme. Mbështetësit e kësaj teorie besojnë se kontributi i Rusisë në kulturën botërore po minimizohet qëllimisht. Në mendjen e presidentit të saj, Rusia nuk është thjesht një shtet, por një civilizim.<sup>31</sup> Në këtë botëkuptim, pozita e posaçme dhe tiparet e

shtetit rus burojnë nga ky model i shtetit-civilizim. Elementet themelore të këtij modeli janë një komb i vetëm, një shtet i vetëm (i mëparshëm), një gjuhë e vetme, një fe e vetme (dominuese në nivel shtetëror) dhe një kulturë e vetme.

Për të promovuar këtë koncept të “Botës Ruse”, janë krijuar një sërë institucionesh të ashtuquajtura të diplomacisë kulturore (Rossotrudnichestvo, Instituti i Bashkëkombësve, Fondacioni Bota Ruse). Kështu, Rossotrudnichestvo është një agjenci federale nën Ministrinë e Jashtme të Federatës Ruse, me misionin kryesor “për të forcuar ndikimin humanitar të Rusisë në botë”. Me një trashëgimi institucionale që daton nga viti 1925, organizata ka prezencë në 71 vende të botës (përfshirë në Serbi, Shqipëri, Greqi dhe Bullgari) përmes 87 misioneve të huaja. Që nga viti 2021, ajo njihet formalisht si “Shtëpia Ruse”.<sup>32</sup> Këto zyra shpesh operojnë nën ombrellën e ambasadave ose konsullatave ruse dhe madje ndajnë të njëjtën godinë, gjë që e bën të vështirë kontrollin e aktiviteteve të tyre. Vlen të ceket se, sipas rregulloreve, jashtë Federatës Ruse, Rossotrudnichestvo, në marrëveshje me Ministrinë e Jashtme, i kryen funksionet e veta përmes zyrave përfaqësuese të Rossotrudnichestvo, qendrave ruse për shkencë dhe kulturë jashtë vendit, qendrave ruse të informacionit dhe kulturës jashtë vendit, shtëpive ruse të shkencës dhe kulturës jashtë vendit, qendrave kulturore ruse jashtë vendit dhe degëve përkatëse, ose përmes përfaqësuesve të saj brenda misioneve diplomatike të Federatës Ruse.<sup>33</sup>

Arsimi është një nga instrumentet kryesore të Rossotrudnichestvo, me mijëra bursa që ofrohen çdo vit për studentët e huaj në më shumë se 400 universitete ruse. Në vitin 2024, rreth 20,000 programe në 433 universitete ruse u

30 Shih: Institute for Cultural Diplomacy, [https://www.culturaldiplomacy.org/index.php?en\\_culturaldiplomacy](https://www.culturaldiplomacy.org/index.php?en_culturaldiplomacy)

31 TASS (17 maj 2020). Putin: The future of Russian civilization depends on success in the development of high technologies. <https://nauka.tass.ru/nauka/8493647>

32 <https://rs.gov.ru/en/about-foiv>

33 Rregulloret për Agjencinë Federale për Komunitetin e Shteteve të Pavarura, bashkëkombësit që jetojnë jashtë dhe bashkëpunimin humanitar ndërkombëtar, Dekreti nr. 1315 i presidentit të Federatës Ruse, datë 6 shtator 2008. <https://rs.gov.ru/app/uploads/2023/04/polozhenie-o-rossotrudnichestve.pdf>

hapën për studentët e huaj. Agjencia koordinon punën e zyrave përfaqësuese dhe institucioneve diplomatike në përzgjedhjen e qytetarëve të huaj, personave pa shtetësi dhe bashkëkombësve që jetojnë jashtë për studime të mëtejshme në universitetet ruse, sipas kuotës qeveritare prej 30,000 personash. Numri i të rinjve nga vende të tjera që shprehen të gatshëm të studiojnë falas në Rusi u rrit nga 54,000 në 77,000 në vitin 2024. Zyrat përfaqësuese të Rossotrudnichestvo jo vetëm që punojnë aktivisht me kandidatët e huaj për studime, por gjithashtu mbajnë një ndërveprim të gjerë me ish-studentët ndërkombëtarë, numri i të cilëve tejkalon 500,000.<sup>34</sup> Krahas kësaj, agjencia promovon gjuhën ruse përmes qendrave të dedikuara, kurseve dhe madje edhe “shkollave ruse” mobile.

Shtrirja e kontakteve ndërgjegjësuese kulturore është një element tjetër kyç, që përfshin organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare si shfaqje filmash, panaire librash, ekspozita, konferenca dhe të ashtuquajturën “Dita e Rosisë”.<sup>35</sup> Iniciativat e orientuara drejt të rinjve luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm, me programe si Brezi i Ri (ang. New Generation) dhe Festivali Botëror i Rinisë në Soçi (ang. Sochi World Youth Festival), të projektuara për të angazhuar liderët e rinj jashtë vendit. Gjatë 10 viteve të fundit, numri i vendeve pjesëmarrëse në programin New Generation ka arritur në 153, ndërsa numri i pjesëmarrësve ka tejkaluar 10,000 (në vitin 2024, pati 900 pjesëmarrës nga 66 vende).<sup>36</sup>

34 Raport zyrtar i Rossotrudnichestvo për vitin 2024. [https://rs.gov.ru/app/uploads/2025/07/183cfe\\_rossotrudnichestvo\\_2024.pdf](https://rs.gov.ru/app/uploads/2025/07/183cfe_rossotrudnichestvo_2024.pdf)

35 Shih: <https://tass.ru/politika/24205727>; <https://bigasia.ru/den-rossii-otmetili-v-russkih-domah-po-vsej-azii>

36 Raport zyrtar i Rossotrudnichestvo për vitin

Rossotrudnichestvo punon gjerësisht edhe me komunitetet e diasporës, duke e paraqitur angazhimin e vet si mbrojtje të të drejtave të “bashkëkombësve jashtë vendit” dhe ruajtje e identitetit të tyre kulturor. Përveç kësaj, ajo përdor në mënyrë aktive platformat mediatike dhe informative—rrjete sociale, faqe interneti, projekte televizive dhe radiofonike—për të transmetuar narrativat ruse në nivel ndërkombëtar.<sup>37</sup>

Në Ukrainë, zyrat e Rossotrudnichestvo ishin aktive në Kiev, Odesa dhe Sevastopol. Në vitin 2018, Shërbimi i Sigurisë së Ukrainës (SBU) zbuloi aktivitete anti-ukrainase nga stafi i Rossotrudnichestvo në Konsullatën e Përgjithshme Ruse në Odesa, përfshirë bashkëpunimin me grupe qytetare pro-ruse nën petkun e “Programeve Humanitare dhe Sociale”. Një punonjës i konsullatës, i cili u vërtetua se kishte lidhje me shërbimet e sigurisë ruse, u shpall persona non grata. Procesi i ndalimit të Rossotrudnichestvo në Ukrainë kërkoi shfuqizimin e marrëveshjes bilaterale mbi qendrat kulturore. Në prill 2021, Dekreti Presidencial nr.140/2021 vendosi sanksione që praktikisht i pushuan aktivitetet e Rossotrudnichestvo për tre vjet. Vendimi pasoi një ngjarje të diskutueshme në Kiev në mars 2021, në Qendrën Ruse të Shkencës dhe Kulturës, e cila tentoi të përvetësonte trashëgiminë e Taras Shevchenko. Pavarësisht ndalimit, më 30 nëntor 2021, Rusia hapi një “Shtëpi Ruse” në Donetskun e pushtuar.<sup>38</sup>

2024. [https://rs.gov.ru/app/uploads/2025/07/183cfe\\_rossotrudnichestvo\\_2024.pdf](https://rs.gov.ru/app/uploads/2025/07/183cfe_rossotrudnichestvo_2024.pdf)

37 Shih: <https://ui.org.ua/sectors/rossotrudnichestvo-the-unbearable-harshness-of-soft-power/>

38 Shih: <https://ui.org.ua/sectors/rossotrudnichestvo-the-unbearable-harshness-of-soft-power/>

**Bazuar në hulumtimet e Institutit Ukrainas,<sup>39</sup> kemi krahasuar mjetet e përdorura nga Rossotrudnichestvo në Ukrainë (para dhe pas agresionit) dhe në Serbi.**

Kategoria	Serbia	Ukraina
<b>Infrastruktura</b>	Shtëpia Ruse në Beograd (e hapur në vitin 1933, më e madhja në Evropë).	Në vitin 2008 u hap Qendra Ruse e Shkencës dhe Kulturës në Kiev, ndërsa ajo në Simferopol u hap në vitin 2012 dhe u mbyll në vitin 2014. Një zyrë tjetër përfaqësuese funksiononte pranë Konsullatës së Përgjithshme të Rusisë në Odesa. Qendra Ruse e Shkencës dhe Kulturës (RCSC) në Kiev operoi në mënyrë aktive deri në vitin 2014, duke u përdorur si bazë për aktivitete kulturore dhe edukative, si dhe për angazhimin me komunitetet rusesht-folëse. Pas aneksimit të Krimesë në vitin 2014, autoritetet ukrainase pezulluan punën e tyre. Në vitin 2018, Këshilli i Qytetit të Kievit zyrtarisht ndërpreu kontratën e qirasë dhe ndaloi aktivitetet e mëtejshme.
<b>Arsimi</b>	Kurse të gjuhës ruse me ~1,500 studentë çdo vit.	Para vitit 2014: promovimi i gjuhës ruse, bursa për studentët ukrainas për të studiuar në Rusi, shkolla verore dhe shkëmbime rinore. Fokusi ishte te "bashkëkombësit jashtë vendit."  Pas vitit 2014: programet u shpërbënë, ndërsa bursat u panë si mjete rekrutimi dhe ndikimi.
<b>Ngjarjet kulturore</b>	Dhjetëra aktivitete çdo vit: panairë librash, ekspozita fotografish, festivale muzikore	Para vitit 2014: festivale kulturore ruse, aktivitete për Ditën e Fitores, ekspozita librash dhe shfaqje filmash.  Midis viteve 2014–2022: ngjarjet publike u kufizuan, shumica e aktiviteteve kaluan në ilegalitet ose u zhvendosën në propagandë <i>online</i> .
<b>Politika e kujtesës</b>	Theks i madh mbi përkujtimin e Luftës së Dytë Botërore dhe lidhjet me Kishën Ortodokse Serbe.	Para vitit 2014: përkujtimi i periudhës sovjetike/ Lufta e Dytë Botërore ishte në qendër të aktiviteteve, i vendosur në kornizën e "fitores së përbashkët."  Pas vitit 2014: u pa si një mjet manipulimi politik (narrativat e "fashizmit" në Ukrainë). Aktivitetet u ndaluan pasi Kievi akuzoi <i>Rossotrudnichestvo</i> për përhapjen e ideve separatiste.

39 Agjenci shtetërore në kuadër të Ministrisë së Jashtme të Ukrainës.

Kategoria	Serbia	Ukraina
<b>Programet për të rinjtë</b>	Bashkëpunim me OJQ-të dhe nismat e të rinjve në nivel lokal	Para vitit 2014: kampe verore, shkëmbime dhe forume të të rinjve të financuara nga Rusia, të orientuara drejt të rinjve rusisht-folës në Ukrainë.  Midis viteve 2014–2022: aktivitetet pushuan; autoritetet ukrainase paralajmëruan për tentativa rekrutimi të studentëve dhe aktivistëve.
<b>Puna me diasporën</b>	Lidhje me OJQ dhe gazetarë pro-rusë, dhe me Kishën Ortodokse	Para vitit 2014: fokusi ishte tek ukrainasit rusisht-folës si “bashkëkombës”, organizimi i forumeve, “Ditëve të Gjuhës Ruse” dhe mbështetja për organizatat e diasporës.  Pas vitit 2014: u konsiderua si një mbulesë për ndërhyrje politike dhe mbështetje për grupet pro-ruse në Donbas dhe Krime.
<b>Mjetet mediatike / informative</b>	Shtëpia Ruse si qendër mediatike; narrativat pasqyroheshin nga mediat pro-ruse.	Para vitit 2014: revista kulturore, partneritete lokale, projekte të përbashkëta mediatike me televizionin rus.  Pas vitit 2014: qeveria ukrainase akuzoi RCSC-në si pjesë të fushatës së dezinformimit nga Kremli; deri në vitin 2018, qendra u mbyll ligjërisht dhe të gjitha aktivitetet u ndaluan.

Fondacioni Russkiy Mir është një tjetër institucion rus në fushën e diplomacisë kulturore. Ai është një organizatë e sponsorizuar nga qeveria ruse, e themeluar në vitin 2007 me dekret të presidentit Vladimir Putin. Qëllimi zyrtar i tij është të promovojë gjuhën dhe kulturën ruse në nivel global, të mbështesë programet e mësimdhënies së gjuhës ruse dhe të forcojë ndikimin e Rusisë në botë. Fondacioni synon të rivendosë lidhjet e diasporës ruse me atdheun dhe të angazhohet me këdo që ka interes për gjuhën dhe kulturën ruse. Ai e realizon këtë përmes krijimit të “Qendrave Ruse” jashtë vendit, të cilat shërbejnë si qendra për aktivitete kulturore dhe edukative. Këto qendra ofrojnë kurse gjuhe, organizojnë ngjarje kulturore, sigurojnë qasje në burime informative dhe mbajnë konferenca e takime për të nxitur komunikimin dhe ndjenjën e përkatësisë në komunitet të përbashkët. Puna e fondacionit është përshkruar nga disa vëzhgues si një mjet i “fuqisë së butë” dhe propagandës ruse, që synon

të promovojë një perspektivë pro-ruse dhe vlera tradicionale, duke shërbyer njëkohësisht për të legjitimuar politikën e jashtme të Rusisë.<sup>40</sup>

Ky fondacion është shumë aktiv në Ballkan (posaçërisht në Bullgari dhe Serbi). Në Serbi, aktivitetet e fondacionit Russkiy Mir janë të përqendruara në dy zyra, në Novi Sad dhe në Beograd. Organizata dhe partnerët e saj në Serbi janë të përkushtuar ndaj promovimit të kulturës, gjuhës dhe trashëgimisë historike ruse. Këto përpjekje nuk janë thjesht ngjarje të njëhershme, por një fushatë e vazhdueshme dhe shumëdimensionale për të forcuar lidhjen kulturore, shoqërore dhe politike midis Rusisë dhe Serbisë.<sup>41</sup> Në uebsajtin e organizatës mund

40 Russkiymir. Shih: <https://russkiymir.ru/>

41 Shih: [https://russkiymir.ru/en/news/?arrFilter\\_DATE\\_CREATE\\_1&arrFilter\\_DATE\\_CREATE\\_2=&arrFilter\\_pf%5Bcountry%5D%5B0%5D=1469&set\\_filter=Y](https://russkiymir.ru/en/news/?arrFilter_DATE_CREATE_1&arrFilter_DATE_CREATE_2=&arrFilter_pf%5Bcountry%5D%5B0%5D=1469&set_filter=Y)



# Përfundime

---

Ndikimi i Rusisë në Kosovë ushtrohet kryesisht përmes popullsisë serbe, duke shfrytëzuar fenë e përbashkët, kujtesën historike dhe lidhjet kulturore për të mëtuar fuqi rajonale dhe për të sfiduar ndikimin perëndimor. Ndërsa ndikimi i drejtpërdrejtë i Rusisë mbi Kosovën është i kufizuar, Moska e instrumentalizon në mënyrë strategjike çështjen e Kosovës për të minuar sovranitetin e saj, për të penguar integrimin ndërkombëtar dhe për të përforcuar përafrimin e Serbisë me interesat ruse.

Elementet kryesore të strategjisë së Rusisë përfshijnë fushata dezinformimi, propagandë që e paraqet Kosovën si një “shtet të dështuar” dhe promovimin e narrativave nacionaliste e ekstremiste. Këto përpjekje synojnë të rrisin tensionet ndëretnike, të de-legjitimojnë institucionet ndërkombëtare dhe të dobësojnë besimin publik në iniciativat e udhëhequra nga Perëndimi. Paralelet me strategjitë ruse në Ukrainë nxjerrin në pah konsistencën e narrativave të saj, si për shembull paraqitja e shteteve të synuara si të paafta për vetëqeverisje dhe të varura nga fuqitë e jashtme.

Krahasimi i ndikimit rus në Ukrainë dhe Kosovë tregon një strategji të qëllimshme dhe shumë-shtresore, e cila kombinon diplomacinë kulturore, narrativat historike, ndikimin fetar dhe instrumentalizimin e komuniteteve minoritare për të avancuar objektivat gjeopolitike të Moskës.

Në Ukrainë, Rusia përdori agjencinë Rossotrudnichestvo, programe edukative, nisma për të rinjtë, rrjete të diasporës dhe platforma mediatike si instrumente të “fuqisë së butë”, me synimin për të formësuar identitetin, për të nxitur varësinë nga Rusia dhe për të minuar sovranitetin ukrainas. Shteti rus shfrytëzoi narrativat historike, si vazhdimësia e shtetit mesjetar rus të Kievit dhe

uniteti shpirtëror i popujve rusë e ukrainas, për të legjitimuar ndërhyrje si aneksimi i Krimesë dhe destabilizimi i Donbasit.

Në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, Rusia aplikon strategji të ngjashme, megjithëse mjetet shpesh janë indirekte dhe përqendrohen në ndikimin mbi elitat politike, popullsitë minoritare, si dhe institucionet kulturore e fetare. Përmes lidhjeve të ngushta me Serbinë, Kishën Ortodokse Serbe, organizatat e diasporës dhe narrivat e kujtesës historike, me theks të posaçëm te trashëgimia e Betejës së Kosovës dhe identiteti i përbashkët sllav/ortodoks, Rusia ruan një prani të qëndrueshme në rajon. Iniciativa si fondacioni Russkiy Mir dhe këshillat koordinuese të bashkëkombësve rusë promovojnë angazhimin kulturor, edukativ dhe mediatik, me synimin për të forcuar ndjenjat pro-ruse, për të përhapur narrativa anti-perëndimore dhe për të penguar integrimin në BE dhe NATO.

Ndërsa konteksti gjeopolitik ndryshon, agresion ushtarak i hapur në Ukrainë kundrejt ndikimit hibrid dhe “fuqisë së butë” në Kosovë dhe Ballkan, strategjia themelore e Rusisë mbetet e pandryshueshme: një kombinim i mjeteve ideologjike, kulturore, fetare dhe politike për të ruajtur sferën e ndikimit, për të dobësuar qeverisjen e orientuar drejt Perëndimit dhe për të mbajtur në veprim levat e ndikimit mbi aktorët lokalë. Kuptimi i këtyre paraleleve ofron njohuri kritike për politikë-bërësit, institucionet e sigurisë dhe aktorët e shoqërisë civile që synojnë t'u kundërvihen kërcënimeve hibride, të mbrojnë sovranitetin dhe të forcojnë reziliencën si në Ballkanin Perëndimor ashtu edhe në Evropën Lindore.



**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



**CENSS**  
Center for Security Studies



## ARSENALI NË RITJE I VEPRIMEVE TË RUSISË: LIDHJA KOSOVË – UKRAINË

### PUBLIKUAR NGA:

- © Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)
- © Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS)
- © Qendra për Studime të Sigurisë (“CENSS”)

### AUTORË:

Adelina Hasani, Vadym Chernysh, Viktoriia Voronina

### DIZAJNI DHE PARAQITJE:

Brand Vision Shpk  
Contact: +383 45 559 923  
Email: brandvision.rks@gmail.com

---

© Qëndrimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë medoemos qëndrimet e Konrad-Adenauer-Stiftung. Publikimi ka karakter informues dhe nuk lejohet të përdoret nga partitë politike apo nga kandidatët dhe mbështetësit e tyre për qëllime të fushatës elektorale



Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

327(47)(496.51+477)(047)

Hasani, Adelina - Chernysh, Vadym - Voronina, Viktoriia

Arsenali në rritje i veprimeve të Rusisë : lidhja Kosovë - Adelina Hasani, Vadym Chernysh, Voronina, Viktoriia. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2025. – 30 f. ; 24 cm.

1. Hasani, Adelina 2. Chernysh, Vadym 3. Voronina, Viktoriia

ISBN 978-9951-842-53-2



**QKSS**  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



**CENSS**  
Center for Security Studies



**KONRAD  
ADENAUER  
STIFTUNG**

## Rreth QKSS-së

E themeluar në prill 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është organizatë e specializuar, e pavarur dhe joqeveritare. Qëllimi kryesor i QKSS-së është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën hulumtuese dhe të avokimit në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë (RSS) duke mbështetur programet RSS nëpërmjet hulumtimeve, ngjarjeve, trajnimeve, avokimeve dhe këshillave të drejtpërdrejta të politikës.

Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon një numër të madh të raporteve, dokumente të politikave dhe dokumente të shkurtra të politikave. Gjithashtu, organizon më shumë se 200 evente publike duke përfshirë konferenca, tryeza të rrumbullakëta, debate dhe ligjërata në Kosovë, dhe në bashkëpunim me partnerët regional dhe ndërkombëtar.

Një sferë e gjerë e aktiviteteve përfshijnë hulumtimet, ndërtimin e kapaciteteve, ndërgjegjësimin dhe avokimin. Puna e QKSS mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë, por pa u kufizuar në reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë; identifikimin dhe analizimin e risqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar; politikën e jashtme dhe bashkëpunimin rajonal; dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

## Rreth KAS-it

Konrad-Adenauer-Stiftung është fondacion politik gjerman që u zhvillua nga Shoqata për Punën Edukative Demokristiane, e themeluar në vitin 1955. Prej vitit 1964, mban emrin e Kancelarit të parë Federal, Konrad Adenauer. Ne ndihemi të lidhur me kujtesën dhe trashëgiminë politike të Adenauer; parimet e tij shërbejnë si udhëzime, mision dhe përkushtim për ne. Prandaj, jemi të lidhur politikisht me Unionin Kristian Demokrat të Gjermanisë, por jemi të pavarur financiarisht dhe organizativisht.

Promovimi i demokracisë liberale dhe një ekonomie sociale të tregut, i paqes dhe lirisë, marrëdhënieve transatlantike dhe unifikimit evropian - kjo është çka e përfaqëson Konrad-Adenauer-Stiftung.

Edhe pse puna në Kosovë filloi shumë më herët përmes projekteve të ndryshme, KAS u regjistrua zyrtarisht në Prishtinë në qershor 2007. Prej atëherë, KAS është fokusuar në edukimin politik, edukimin qytetar dhe forcimin e shoqërisë civile, integrimin evropian, mbështetjen e dialogut ndëretnik dhe ndërfaqësor, promovimin e ekonomisë së tregut të lirë dhe tema të tjera, të cilat së bashku me partnerët tanë lokal dhe ndërkombëtarë, i kemi trajtuar përmes seminareve, konferencave, diskutimeve dhe botimeve të shumta.

## Rreth "CENSS"

Qendra për Studime të Sigurisë "CENSS" është një institut kërkimor ukrainas i themeluar në vitin 2013, i fokusuar në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, administratën publike, reagimin ndaj krizave dhe luftimin e trafikut të paligjshëm të armëve. CENSS kryen kërkime të aplikuara, zhvillon propozime politike dhe forcon qëndrueshmërinë institucionale. Ekipi i saj përdor mjete OSINT dhe bashkëpunon me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, institucione shtetërore, OJQ dhe akademinë.

ISBN 978-9951-842-53-2



9 789951 842532